



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE TE QYTETIT
KORCE

VENDIM

Nr 10P Datë 31.10.08

Miratim i fondit për implementimin e projektit të perbashket të Bashkise Korce, Universitetit "F.S.Noli", Akademise së Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe drejtorisë Arsimore Rajonale Korce, "Nga Evëtarët e Naum Veqilharxhit tek Kongresi i Manastirit"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korcës, mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit strategjik dhe Koordinimit me donatorët, në lidhje me financimin e pjesëshëm për aktivitetet me rastin e 100 vjetorit të Kongresit të Manastirit, në bazë të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 8399 dt. 09.09.2008 "Për buxhetin lokal", Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008",

VENDOSI:

1.Miratimin e fondit total prej 150 000 leke për implementimin e projektit "Nga Evetaret e Naum Veqilharxhit tek Kongresi i Manastirit me kete buxhet:

Shpenzime për darken që do të organizojë Bashkia:

Darka e mbylljes së Konferencës 50 persona x 2000 leke/person = 100 000 leke

Shpenzime për promovim 50 000 leke

Totali : 150 000 leke

2.Ky fond do të perballohet nga fondi rezerve i të ardhurave të Bashkisë, me kete strukture buxhetore:

Pakesohet 00 04980 05 Art 6090000 - 150.000

Shtohet 00 01110 .05 Art 6020000 + 150.000

3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria E Politikave Të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik Dhe Koordinimit Me Donatorët, Drejtoria e Finances dhe Drejtoria Juridike

4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI
RAJMONDA NASE

Rajmonda Nare

Dixhitalizuar nga Qendra e Informacionit
www.infocip.org